



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**I.Numër:463/01-36011, Dt. 28 Maj 2024**

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Arton Kelmendi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 28 Maj 2024, merr këtë:

**VENDIM  
Nr.13/2024**

**Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Arton Kelmendit me qëllim të realizimit të “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra-Pejë”, sipas Planit Zhvillimor Komunal.**

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të realizimit të “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra-Pejë”, sipas Planit Zhvillimor Komunal .
- II. Parcela kadastrale nr.2710-2 në sipërfaqe prej 191m<sup>2</sup> ZK Pejë pronë e pronarit Arton Kelmendi do të merret për nevoja të realizimit të “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra-Pejë dhe në të njejtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr.6269-3 në sipërfaqe prej 191m<sup>2</sup> ZK Pejë pronë Komuna Pejë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 17.04.2024.
  - Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr.6269-3 në sipërfaqe prej 191m<sup>2</sup> ZK Pejë është vlerësuar 430.00 €/m<sup>2</sup>.
  - Prona private e Arton Kelmendit, ngastra kadastrale nr.2710-2 në sipërfaqe prej 191 m<sup>2</sup> ZK Pejë është vlerësuar 430.00 €/m<sup>2</sup>.
  - Pasi që pronat kanë sipërfaqe të njejtë dhe vlerësimi po ashtu është i njejtë palët nuk kanë obligime financiare ndaj njëra tjetres.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do të nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Çështje Pronësoro–Juridike.

VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

**Vendimi ti dërgohet:**  
MAPL,  
Kryetarit të Komunës,  
DÇPJ,  
Arkiv.

